

URDHËR
Nr.532, datë 6.12.2004

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E MINISTRIT NR.98, DATË 26.2.2004 "MBI
TARIFAT E TË ARDHURAVE DYTËSORE, TË APLIKUESHME NGA INSTITUCIONET
VARTËSE TË SISTEMIT TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT"**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.07.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve,

URDHËROJ:

Në urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit nr.98, datë 26.2.2004 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1/IV. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve bëhet si vijon:

IV. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve, në mbështetje të ligjit nr.7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", tarifat e shërbimeve që do të kryhen nga inspektorët e mbrojtjes së bimëve të DRBU-së, të jenë:

PËR MBROJTJEN E BIMËVE

A. Inspektim fitosanitar i bimëve dhe produkteve bimore:

Inspektim fitosanitar dhe/ose pajisje me certifikatë fitosanitare për bimët e produktet bimore që importohen, eksportohen, rieksporohen ose lëvizin brenda vendit.

1. Material mbjellës

1.1 Fidanë të drufrutorëve, hardhive, ullinjve, bimëve dekorative dhe lule në vazo

deri 1000 copë 500 lekë

mbi 1000, për çdo 100 copë shtesë 50 lekë

mbi 5000 copë 3000 lekë

1.2 Fidanë të perimeve e luleve , lule të prera për buqeta dhe pjesë vegjetative për prodhim fidanësh drufrutorë, vreshti etj.

deri 10 000 copë 500 lekë

mbi 10 000, për çdo 1000 copë shtesë 50 lekë

mbi 50 000 copë 3000 lekë

1.3 Fara të imta të luleve e perimeve (domate e solanace të tjera, lakër e kryqore të tjera, karrotë, erëza të ndryshme, trangull dhe kukurbitace të tjera etj.)

deri 10 kg 1000 lekë

mbi 10 kg, për çdo 10 kg shtesë 100 lekë

mbi 100 kg 3000 lekë

1.4 Farëra të mëdha si tuberë, bulba, drithëra, bishtajore, spinaq, bamje, foragjere dhe të tjera të ndryshme nga farërat e përmendura në pikën 1.3

deri në 10 ton 1000 lekë

mbi 10 ton, për çdo 1 ton shtesë 100 lekë

mbi 30 ton 5000 lekë

2. Lëndë druri

deri në 10 ton ose m³ 500 lekë

mbi 10 ton, për çdo 1 ton ose m³ shtesë 100 lekë

mbi 30 ton ose m³ 3000 lekë

3. Tokë, komposto dhe mjedise të tjera organike dhe inorganike për kultivimin e bimëve

deri në 10 ton 500 lekë

mbi 10 ton, për çdo 1 ton shtesë	100 lekë
mbi 30 ton	3000 lekë

4. Bimë e produkte bimore për konsum

deri 10 ton	500 lekë
mbi 10 ton, për çdo 1 ton shtesë	50 lekë
mbi 30 ton	2000 lekë

B. Inspektime fitosanitare fushore për një cikël bimor

1. Inspektim fushor për material mbjellës e shumëzues

Parcela deri në 1 ha	1000 lekë
mbi 1 ha, për çdo 1 ha shtesë	100 lekë
mbi 40 ha	5000 lekë

2. Inspektim fushor për bimë e produkte bimore për konsum

Parcela deri në 10 ha	500 lekë
mbi 10 ha, për çdo 1 ha shtesë	50 lekë
mbi 20 ha	2000 lekë

C. Shërbime të tjera:

1. Leje për importimin dhe tregtimin e PMB	5000 lekë
2. Inspektimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në pikat kufitare të hyrjes	1000 lekë për çdo produkt

D. Diagnostikim në laborator:

1. Diagnostikim sëmundjesh dhe dëmtuesish me metoda mikroskopike	1000 lekë për çdo diagnostikim
--	--------------------------------

2. Diagnostikim sëmundjesh e dëmtuesish me metoda laboratorike (mbjellje, kultivim artificial etj.)	2000 lekë për çdo diagnostikim
---	--------------------------------

Shënim. Vlera e tarifës i përgjigjet mallit të një partie, që do të thotë kg, ton, m² apo copë, bimë e produkte bimore që :

- i përkasin të njëjtit lloj/kultivar;
- kanë të njëjtën origjinë;
- gjendja fitosanitare e tyre deklarohet në një certifikatë fitosanitare.

2. Kreu IV i urdhrit të Ministrit nr.98, datë 26.2.2004 "Mbi tarifat e të ardhurave dytësore, të aplikueshme nga institucionet vartëse të sistemit të bujqësisë dhe të ushqimit" që ka të bëjë me tarifat e aplikueshme nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimeve, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe të Ushqimit

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, si dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
Agron Duka